

20141785544

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR
FINANCIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I SEGMENTIT TË RI DHE
RIKONSTRUKTIMI I SEGMENTIT EKZISTUES BELAKOVC - KRIVA PALLANKË -
PJESA LINDORE E HEKURUDHËS SË KORRIDORIT VIII, FAZA 2"**

Neni 1

Republika e Maqedonisë merr hua te Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në shumë prej 145 000 000 euro, të dedikuar për realizimin e projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovc - Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2".

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për financimin e projektit "Ndërtimi i segmentit të ri dhe rikonstruktimi i segmentit ekzistues Belakovc - Kriva Pallankë - pjesa lindore e hekurudhës së Korridorit VIII, faza 2", që do të lidhet ndërmjet Republikë së Maqedonisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim .

Në emër të Republikës së Maqedonisë Marrëveshjen për hua nga neni 1 i këtij ligji do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 15 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është variabile dhe përbëhet nga EURIBOR gjashtëmujor të zmadhuar për margjinë prej 1%.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim provizion të njëhershëm në lartësi prej 1 %.

Për shumën e mjeteve të patërhequra të huas Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim do t'i paguhet provizion në lartësi prej 0,5% të shumës së mjeteve të patërhequra të huas në nivel vjetor.

Neni 4

Për realizimin e projektit nga neni 1 i këtij ligji, Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup do të lidhë Marrëveshje të projektit me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 5

Projektin do ta implementojë Ndërmarrja Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministrinë e Financave.

Neni 6

Për mjete e huas nga neni 1 i këtij ligji do të lidhet Marrëveshje për nënhua ndërmjet Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 7

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga mjetet që do të grumbullohen me pagesën e mjeteve të marra hua të Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore "Hekurudhat e Maqedonisë" - Shkup, në pajtim me Marrëveshjen për nënhua nga neni 6 i këtij ligji.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".